



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

ANEKSI Nr. 1

KUSHTET E VEÇANTA TË SHËRBIMEVE DHE TARIFAVE

Në këtë Aneks, pasqyrohen shërbimet bazë dhe shtesë të ofruara nga ONE ALBANIA SHA. dhe të zgjedhura nga Pajtimtari, kushtet e veçanta, tarifat përkatëse të shërbimeve si dhe mënyra e tarifimit.

- Plani One Business Ultra Max+ S me Kontratë

Programi	One Business Ultra Max+ S
Pajtimi Mujor (Kontratë 12 mujore)	2,550 Lekë
Pajtimi Mujor (Kontratë 24 mujore)	2,450 Lekë
Minuta Kombëtare	Pa limit
Minuta Ndërkombëtare	150
SMS Kombëtare	Pa limit
Internet	Pa limit
Tarifat/Minutë (pas konsumimit të njësisive falas)	
Minuta drejt të gjitha destinacioneve Kombëtare	9.20
Tarifat/Sekondë (pas konsumimit të njësisive falas)	
Kombëtare	0.15
Shërbime të tjera	
SMS Kombëtare	4.09
SMS Ndërkombëtare	9.20
Tarifat ndërkombëtare/minutë (pas konsumimit të njësisive falas)	
Zona 1	61.31
Zona 2	113.43
Zona 3	128.76
Zona 4	233.01
Zona 5	367.91
Tarifat ndërkombëtare/sekondë	
Zona 1	1.02
Zona 2	1.89
Zona 3	2.15
Zona 4	3.88
Zona 5	6.13
Paketat e Internetit Roaming	
Paketa Ditore Internet, 150 MB = 250 lekë	Paketat janë te vlefshme në të gjitha shtetet e Zonës
Paketa Javore Internet, 1.5 GB = 1500 lekë	
Paketa 10 Ditore, 6 GB, 200 minuta drejt ONE, 10 minuta drejt të gjithëve, 50 minuta hyrëse, 200 SMS = 1600 lekë	



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

SHËNIME

1. Politika e drejtë e përdorimit për paketën me minuta falas pa limit do të jetë 10,000 minuta.
2. Politika e drejtë e përdorimit për paketën me SMS falas pa limit do të jetë 3,000 SMS.
3. Interneti do të përdoret pa limit me shpejtësi maksimale.
4. Për volumin ditor të internetit do të zbatohet një politikë e drejtë përdorimi: 50 GB në ditë. Nëse tejkalohet ky volum ditor shpejtësia e internetit do të zbrësë 128kbps. Pajtimtarit do ti rikthehet shpejtësia maksimale e internetit brenda orës 00:00 dhe 00:59 të ditës tjetër.
5. Destinacionet e vlefshme për minutat ndërkombëtare të përfshira në program – 30 shtete: Rumani, Austri, Bullgari, Suedi, Poloni, Norvegji, Republika Çeke, Sloveni, Kroaci, Greqi, Itali, Francë, SHBA, Kanada, Mbretëria e Bashkuar, Gjermani, Turqi, Zvicër, Belgjikë, Hollandë, Spanjë, Maqedoni, Kosovë, Serbi, Mali i Zi, Kina, Hungaria, Irlandë, Luksemburg, Danimarkë
6. Minutat dhe SMS kombëtare janë të vlefshme edhe në Roaming në Ballkanin Perëndimor.
7. Maksimumi i vëllimit të Internetit i cili është i vlefshëm edhe në Roaming në Ballkanin Perëndimor: 17 GB

Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming:

1- Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming për Ballkanin Perëndimor:

Telefonata Dalëse në Roaming	KOMBËTARE		DESTINACIONE TË TJERA	
	lekë/minutë	lekë/sekondë	lekë/minutë	lekë/sekondë
	9	0.15	120	2
Telefonata Hyrëse në Roaming	NGA SHTETET BP/Shqipëri		NGA DESTINACIONE TË TJERA	
	FALAS		100	1.667
SMS Dalëse në Roaming	KOMBËTARE		DESTINACIONE TË TJERA	
	Lekë/SMS		Lekë/SMS	
	4		15	
SMS Hyrëse në Roaming	FALAS			
Internet në Roaming	lekë/MB		lekë/10KB	
	1.14		0.0111	

2- Tarifat Standarde të Shërbimit Roaming:

TELEFONATA NË ROAMING	TELEFONATA DALËSE NË ROAMING		TELEFONATA HYRËSE NË ROAMING	
	lekë/minutë	lekë/sekondë	lekë/minutë	lekë/sekondë
Zona 1	120	2.0000	100	1.6667
Zona 2	520	8.6667	100	1.6667
Zona 3	780	13.0000	100	1.6667
SMS në Roaming	SMS Dalëse lekë/SMS		SMS Hyrëse lekë/SMS	
Zona 1	15		FALAS	



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

Zona 2	15	
Zona 3	15	
Internet në Roaming	lekë/MB	lekë / 10 KB
Zona 1	2.43	0.0238
Zona 2	180	1.7580
Zona 3	1,600	15.6250

SHËNIME TË PËRGJITHSHME

- 1) Të gjitha tarifat e përcaktuara më sipër përfshijnë TVSH-në.
- 2) Benefitet e përfshira në program janë të vlefshme për një periudhë 1 mujore dhe nuk janë të transferueshme në muajt në vijim.
- 3) Pajtimi mujor dhe njësitë të përfshira në paketë (minuta, SMS, MB) janë proporcionale në varësi të datës së aktivizimit. Ky kusht aplikohet për të gjitha mënyrat e abonimit: aktivizim i ri, transferim, tjetërsim.
- 4) Koha fillestare e tarifimit është 60 sekonda, më pas do të aplikohet tarifimi për sekondë.
- 5) Përlllogaritja e konsumimit të internetit do të bëhet për çdo 10 KB.
- 6) Pajtimtari mund të ndryshojë në çdo kohë planin e tij tarifor, në një plan tjetër tarifor me pajtim mujor më të lartë.
- 7) Kohëzgjatja fillestare, minimale e kontratës është 12 muaj. Në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës prej Pajtimtarit brenda afatit fillestar 12 mujor apo 24 mujor, Pajtimtari ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e tarifës mujore fikse për të gjithë muajt e mbetur deri në përfundimin e afatit të kontratës 12 mujore ose 24 mujore.
- 8) Në rastet kur Pajtimtari ka përfituar një zbritje në cmimin e aparatit të marrë si ofertë specifike dhe kërkon zgjidhje të parakohshme të kontratës, përveç penalitetit të shënuar më sipër dhe vlerës së plotë korresponduese të ofertës specifike, duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfituar në çmimin e aparatit.
- 9) Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga ndonjë ofertë promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale dhe vendos të kryejë zgjidhje të parakohshme të kontratës, së bashku me detyrimet e sipërpërmenduar duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 10) Në rast se Pajtimtari do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, vlerën e diferencës së pageses fikse mujore për të gjithë muajt e mbetur.
- 11) Në rastet kur Pajtimtari ka përfituar një zbritje në cmimin e aparatit të marrë si ofertë specifike, dhe kërkon të bëjë ndryshim e planit, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, ka detyrim të paguajë si penalitet, përveç penalitetit të shënuar më sipër duhet të paguajë gjithashtu dhe vlerën korresponduese të zbritjes së përfituar në çmimin e aparatit.
- 12) Në rastet kur pajtimtari ka përfituar nga ndonjë ofertë promovionale si psh zbritje në pajtimin mujor, sipas kushteve të ofertës promovionale, dhe vendos do të ndryshojë planin, nga një plan me pagesë fikse mujore më të lartë në një plan me pagesë fikse mujore më të ulët, së bashku me detyrimet e sipërpërmenduar duhet të paguajë edhe përfitimet nga oferta promovionale. (shumën e përfitimeve për të gjithë periudhën promovionale).
- 13) Kufiri maksimal i kreditimit i shprehur në lekë, për përdorimin e shërbimeve prej Pajtimtarit sipas programit të zgjedhur, përcaktohet në formularin e pajtimit bashkëlidhur, pjesë e pandashme e kontratës së pajtimit. Shuma e përcaktuar si limit krediti do të aplikohet në përputhje me planin tarifor të zgjedhur prej pajtimtarit. Ky kredit limit do të përdoret për shërbime të cilat nuk janë të përfshira në programin tarifor të zgjedhur, duke i ofruar Pajtimtarit fleksibilitet në përdorim dhe njëkohësisht edhe mundësi për të kontrolluar shpejzimet. Pajtimtari mund të perditesojë në çdo moment limitin e kreditit. Ky perditesim mund të bëhet në çdo dyqan One.
- 14) ONE Albania ka të drejtë të aplikojë një ndryshim të tarifave të një apo më shumë shërbimeve bazuar në ndryshimin mesatar vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit të publikuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT), duke ju referuar treguesit të vitit paraardhës. Operatori ka të drejtë të aplikojë këtë ndryshim jo më shumë se një herë në vit.
- 15) Për të mësuar më shumë mbi shtetet dhe zonat ndërkombëtare klikoni: <https://www.one.al/>

SHËNIME PËR SHËRBIMIN ROAMING

- 16) Paketat, ofertat dhe koha e bisedës falas që pajtimtari ka përfituar duke aktivizuar ndonjë nga paketat bazë apo ato opsionale, nuk janë të vlefshme dhe nuk mund të konsumohen ndërkohë që klienti përdor shërbimin Roaming, përveç shteteve të Ballkanit



One Albania SHA

Adresa: Rruga "Muhedin Llagami", Kompleksi "Square 21", Tiranë, Shqipëri

Phone: +355 42275232 | E-mail: contactus@one.al

Certifikuar: ISO 9001 | ISO 45001 | ISO 14001 | ISO 37001 | ISO 37301 | ISO 27001 | ISO 20000 | BS PAS 99 | ISO 31000 |

NIPT: J61814094W

Perendimor. Gjatë përdorimit të shërbimit Roaming do të aplikohen tarifat e përcaktuara dhe të sipërpërmendura në tabelen 'Tarifat standarde të shërbimit Roaming'.

- 17) Interneti në roaming do të tarifohet për çdo 10 KB. Pas përfundimit të MB të përfshira në paketë, do të aplikohen tarifat standarde të vlefshme në Roaming.
- 18) Koha fillestare e bisedës për telefonatat hyrëse dhe dalëse në Roaming është 60 sekonda. Pas përfundimit të kohës fillestare gjatë këtij shërbimi do të aplikohet tarifimi për sekondë.
- 19) Në mënyrë që të aktivizohet paketat internet të vlefshme për në roaming pajtimtari duhet të sigurohet të aktivizojë shërbimin standard Roaming duke kontaktuar ONE nëpërmjet njëres prej pikave të shitjes.
- 20) Për të mësuar më shumë mbi zonat, shtetet, operatorët, paketat dhe tarifat për njësi për shërbimin Roaming klikoni: <http://smartroam.one.al/>
- 21) Në përputhje me dokumentin referencë ndërkombëtar të përhershëm të GSMA, datë 16.12.2014, Versioni 24.6, "Afatet për transferimin e të dhënave data" për marrëveshjet e Roaming ku shoqëria ONE ALBANIA SHA është palë, në raste të vecanta, mund të krijohen vonesa të shkëmbimit të të dhënave roaming deri në 30 ditë midis operatorëve në marrëdhënie roaming me njëri-tjetrin. Për këtë arsye, në keto raste detyrimi për pajtimtarin për shërbimet roaming të konsumuara në muajin paraardhës mund të pasqyrohen në faturën në vijim në muajin pasardhës.

SHËNIME TË TJERA PËR ZONËN BALLKANI PERENDIMOR:

- 22) Të gjithë Klientët që i përkasin programeve One me kontratë, të rinj dhe ekzistues të cilët do të vizitojnë Shtetet e Ballkanit Perendimor do të mund të përdorin njësitë e përfshira në programin e tyre (minuta kombëtare, SMS kombëtare, Internet) FALAS sikur të ishin në territorin Shqiptar, duke i zbritur ato nga programi perkates me konceptin Roam Like Home (RLAH).
 - i. ONE ka të drejtë të aplikojë Politikën e Përdorimit të Drejtë të Shërbimit të të Dhënave në Roaming sipas Rregullores së AKEP, specifikuar më sipër.
 - ii. Pas konsumit të njërive data internet të lejuara në programin perkates, ONE do të aplikojë një tarifë shtesë prej 1.14 lekë/MB.
- 23) Telefonata dhe SMS Dalëse Kombëtare quhen të gjitha thirrjet e gjeneruara nga shtetet e Ballkanit Perendimor dhe të terminuara në operatorët celularë të shteteve të Ballkanit Perendimor dhe të Shqipërisë. "Destinacionet e tjera" janë operatorët fiks në Shqipëri & Ballkanin Perendimor si dhe shtetet e tjera ndërkombëtare dhe do të tarifohen sipas tabelës me sipër.
- 24) Thirrjet hyrëse prej operatorëve celularë të Ballkanit Perendimor dhe Shqipërisë janë FALAS. Të gjitha thirrjet e tjera të terminuara nga shtetet e tjera (operatorët fiks Shqipëri/Ballkani Perendimor dhe shtetet e tjera ndërkombëtare) do të tarifohen sipas tabelës më sipër.
- 25) Të gjitha SMS hyrëse janë FALAS.
- 26) Tarifimi i minutave dalëse do të kryhet fillimisht për 60 sekondat e para dhe më pas do të vazhdojë për çdo sekondë.
- 27) Tarifimi i minutave hyrëse do të kryhet fillimisht për 30 sekondat e para dhe më pas do të vazhdojë për çdo sekondë.
- 28) Interneti do të tarifohet për çdo 10 KB.
- 29) Shteti i Kosovës, Bosnie Hercegovinës, Mali i zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia do të vazhdojë të jetë te përfshirë tek paketat aktuale të vlefshme në Roaming dhe do të vazhdojnë të ofrohen në treg si një alternative shumë e mirë për klientët me kontratë. (të gjitha rrjetet janë të përfshira në këto paketa). Në keto raste, njësitë të përfshira në program me konceptin RLAH do të kenë prioritet mbi paketat Roaming.

Pajtimtari deklaron se ka lexuar dhe është plotësisht në dijeni të Kushteve të Përgjithshme të dhënies së shërbimeve të telefonisë publike të lëvizshme për Pajtimtarin, të cilat janë pasqyruar dhe mund të aksesohen në link-un e mëposhtëm:

<https://www.one.al/kushtet-e-pergjithshme/>

Pajtimtari deklaron se i ka pranuar pa rezerva dhe nën vullnetin e tij të lirë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimtit.

Këto Kushte të Përgjithshme së bashku me Kushtet e Veçanta të Shërbimeve dhe Tarifave në fuqi, përbëjnë tërësinë e marrëveshjes ndërmjet palëve për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacioneve prej ONE dhe faturimin përkatës të Pajtimtarit.